

**VENDIM**  
**Nr. 15, datë 26.1.2022**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128/2 prot., datë 21.1.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, ‘Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror’, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 1.10.2021, vendosi:

“Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.1.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.

- Në lidhje me plotësimin e kushtit që ka të bëjë me “Lejet dhe autorizimet mjedisore”, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 93 prot., datë 21.6.2021, protokolluar në ERE me nr. 764 prot., datë 21.6.2021, ka bërë me dije se është pajisur me “Vendim për VNM-në paraprake”, dokument i depozituar në ERE dhe i nevojshëm për aplikimin për pajisje me leje mjedisore, e cila mbetet për t’u marrë gjatë vitit 2022.

- Për sa i përket kushtit që ka të bëjë me “Certifikatën e sigurimit”, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se është parashikuar në buxhetin e saj për vitin 2022 pagesa përkatëse dhe do të mbyllet përgjatë këtij viti.

- Shoqëria kërkon shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit që ka të bëjë me depozitimin në ERE të “Certifikatës së sigurimit”, në një datë me atë të kushtit të vendosur për depozitimin në ERE të “Lejeve dhe autorizimeve mjedisore”, pra më datë 20.1.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Për sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202, datë 1.10.2021, dhe duke marrë parasysh përpjekjet e “Albgaz” sh.a. për të plotësuar kushtet e sipërcituara, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.”.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**